



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
KRYESIA

Tiranë më, 3 korrik 2017

Thirrje për pjesëmarrje në konkurrimin për “Anëtar i rregullt”, në  
AKADEMINË E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Mbështetur ligjit Nr.9655, datë 11.12.2006 “PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, neni 6, “Përzgjedhja e anëtarëve” (ndryshuar me ligjin Nr.9949, datë 7.7.2008, neni 1); Statutit organik të saj, neni 4; “Kodit evropian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor” si dhe vendimit nr. 15, datë 30.06.2017 të Asamblesë së Akademisë së Shkencave për hapjen e 6 vendeve për “Akademik të rregullt” (anëtarë të Asamblesë së Akademisë së Shkencave), si më poshtë:

- 1 (një vend) në fushën **gjuhësi**, në seksionin e shkencave shoqërore e albanologjike
- 1 (një vend) në fushën **drejtësi**, në seksionin e shkencave shoqërore e albanologjike
- 1 (një vend) në fushën **sociologji**, në seksionin e shkencave shoqërore e albanologjike
- 1 (një vend) në fushën **biologji**, në seksionin e shkencave natyrore e teknike
- 1 (një vend) në fushën **kimi**, në seksionin e shkencave natyrore e teknike
- 1 (një vend) në fushën **mjekësi**, në seksionin e shkencave natyrore e teknike

Sa më sipër, ftojme kandidatët me titullin “akademik i asociuar” për aplikim përmes kësaj thirrjeje publike për pjesëmarrje.

**I. Sipas procedurës së parashikuar të aplikimit, kandidatët duhet të paraqesin:**

1. Kërkesë personale për aplikim drejtuar zyrtarisht Akademisë së Shkencave.
2. Fotokopjen e kartës së identitetit/pasaportës, që vërteton se kanë ose kanë pasur shtetësi shqiptare.
3. Dëshmi që, nëpërmjet punimeve dhe veprave shkencore, kanë dhënë ndihmesë të rëndësishme në zhvillimin e shkencës si dhe në formimin universitar e pasuniversitar të shkencëtarëve të rinj, për periudhën pas fitimit të titullit “Akademik i asociuar”.
4. Kandidatët nuk duhet të kenë mbushur moshën 75 vjeç.



5. Funkionarët e lartë të administratës shtetërore dhe të partive politike nuk mund të kandidojnë për t'u zgjedhur anëtarë të rregullt të Akademisë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

6. "Formulari Aplikimi për informim për zyrtarët përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta" . (sipas nenit 29, pika 1, gërma gj, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë").

Formulari gjendet në webin e Akademisë së Shkencave: <http://akad.gov.al/ash/legjislacioni/formular-vetedeklarimi>

7. Periudha e aplikimit është nga data 3 korrik 2017 deri në datën 17 korrik 2017.

8. Mbledhja e asamblesë për votimin e kandidaturave do të zhvillohet më 4 shtator 2017, ora 11.00 në sallën "Aleks Buda" në Akademinë e Shkencave.

## **II. Procedura e përzgjedhjes**

1. Seksioneve përkatëse të Akademisë, u paraqiten për njohje dhe vlerësim të gjitha dosjet e kandidatëve/eve të paraqitur dhe të regjistruar zyrtarisht në protokollin e ASH-së, pas përfundimit të periudhës së aplikimit.

2. Mbledhja plenare e Seksionit, me votim të fshehtë dhe me shumicën e thjeshtë të votave (jo më pak se 50 % +1) të të gjithë anëtarëve të vet, voton për kandidaturat e paraqitura.

3. Rezultatet e votimit, i cili ka vlerë këshillimore, si dhe dosjet e gjithë kandidatëve, i përcillen Kryesisë së Akademisë, e cila ia parashtron për shqyrtim e miratim Asamblesë në mbledhjen më të parë.

4. Asambleja voton pa debat. në mënyrë të fshehtë dhe kandidati që merr 50% + 1 të votave të  $\frac{3}{4}$  të Asamblesë, shpallet fitues.

5. Po qe se asnjëri nga kandidatët nuk fiton votat e shumicës së të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Akademisë (jo më pak se 50%+1), votimi përsëritet veç e veç për kandidatët që kanë fituar jo më pak se 40 për qind të votave (aq kandidatë sa është numri i caktuar) dhe fitojnë përfundimisht kandidati ose kandidatët që kanë marrë shumicën e thjeshtë të votave (jo më pak se 50%+1) të anëtarëve të pranishëm të Asamblesë së Akademisë.

**Akademia e Shkencave e Shqipërisë**

